

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË LIPJAN

PROJEKTET E MONITORUARA
“RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS AJET KOZHANI POTUROFC DHE RIBAR I MADH”
“RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS DOBROTIN – SLOVI”
“NDËRTIMI I SHËTËPISË MUZE TË VETERANËVE TË UÇK-SË, KROJ MIR”
“MURI GABION NË FSHATIN GADIME E ULËT (TE SHPELLA)”





Nëntor 2025

Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo. Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË LIPJAN

PROJEKTET E MONITORUARA

“RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS AJET KOZHANI POTUROFC DHE RIBAR I MADH”

“RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS DOBROTIN – SLOVI”

“NDËRTIMI I SHTËPISË MUZE TË VETERANËVE TË UÇK-SË, KROJMIR”

“MURI GABION NË FSHATIN GADIME E ULËT (TE SHPELLA)”



DEMOS Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat. Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Suedeze dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë. Mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës Komunale si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar. Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët. Projekti i DEMOS ka mbështetur edhe ndërtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë qytetarët në vendimarrje duke përfshirë ekipet e Auditimit Social të cilat kanë mbikëqyrur implementimin e projekteve të cilat janë financuar nga Granti i Performancës.

BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë.

Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova në partneritet me Demokraci Plus është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e Auditimit Social në 16 projektet e përgjedhura në gjashtë komuna, Drenas, Lipjan, Istog, Dragash, Kaçanik dhe Mamushë.

Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. D+ tenton integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet e tyre, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie. D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

Youth Association for Human Rights (YAHR) është aktive në promovimin e demokracisë dhe përfshirjes qytetare, fuqizimin e rinisë, dhe avancimin e barazisë gjinore në Komunën e Lipjanit dhe më gjerë. YAHR ka realizuar mbi 100 projekte në komunitet gjatë dekadës së fundit, duke ofruar programe si “Programi për Demokratizim dhe Aktivizëm Qytetar”, “Programi për Rininë,” dhe “Programi për Barazi Gjinore.” Aktivitetet e saj përfshijnë mobilizimin e qytetarëve, përmirësimin e gjendjes së rinisë, dhe avokimin për barazi gjinore. Organizata përdor metoda të ndryshme si dialogu i politikave, avokimi, dhe hulumtimi për të arritur objektivat e saj dhe për të kontribuar në zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë.



PËRMBAJTJA

7	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
8	GJETJET E PËRGJITHSHME NË KATËR PROJEKTET
9	Gjetje specifike në projektin “Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturofc dhe Ribar i madh”
9	Gjetje specifike në projektin “Rikonstruktimi i Rrugës Dobrotin – Sllovi”
10	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i Shtëpisë Muze të Veteranëve të UÇK-së, Krojmir”
10	Gjetjet specifike në projektin “Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët”
11	AMBIENTI KU ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL
12	KAPITULLI I - GJETJET E PËRBASHKËTA NË TË KATËR PROJEKTET
14	KAPITULLI II - GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS AJET KOZHANI POTUROFC DHE RIBAR I MADH”
16	KAPITULLI III - GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS DOBROTIN – SLLOVI”
18	KAPITULLI IV - GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “NDËRTIMI I SHTËPISË MUZE TË VETERANËVE TË UÇK-SË, KROJMIR”
20	KAPITULLI V - GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “NDËRTIMI I MURIT GABION, RREGULLIMI I PARKINGUT DHE NDËRTIMI I STACIONIT TË AUTOBUSIT NË GADIME TË ULËT”
21	REKOMANDIME
21	Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve dhe në procesin e prokurimit publik
21	Rekomandimet për projektin rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani – Poturofc dhe Ribar i Madh
22	Rekomandimet për projektin rikonstruktimi i rrugës Dobrotin – Sllovi
23	Rekomandimet për projektin ndërtimi i shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së në Krojmir
23	Rekomandimet për projektin e ndërtimit të murit gabion, rregullimit të parkingut dhe stacionit të autobusit në Gadime të Ulët
24	METODOLOGJIA
25	Kush e themelon ekipin e Auditimit Social?
25	Si u grumbulluan të dhënat?
25	Validimi i të dhënave
26	Përbërja e ekipit
26	Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social
27	EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË LIPJAN GJETJET E PËRGJITHSHME
28	LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT
29	LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E LIPJANIT

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me metodologjinë e paracaktuar, D+ dhe OJQ YAHR lehtësuan procesin e themelimit të ekipit të “Auditimit Social” në Komunën e Lipjanit. Brenda tre muajsh, ekipi u angazhua për të analizuar dhe mbikëqyrur katër projekte, “Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturofc dhe Ribar i Madh”, “Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi”, “Ndërtimi i shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së, Krojmir” dhe “Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)”. Vlera e këtyre projekteve është 240,228.25 euro.

Ekipi i Auditimit Social punoi në grupe të veçanta për monitorimin në terren dhe pas përfundimit të projekteve, zhvilloi konsultime të përbashkëta për evidentimin e gjetjeve të përgjithshme dhe specifike për secilin projekt. Nga monitorimi u identifikuan një sërë çështjesh kryesore lidhur me transparencën, cilësinë e punimeve dhe respektimin e afateve kohore. Bazuar në këto gjetje, u përgatitën rekomandime konkrete për komunën për përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe monitorimit të projekteve publike.

Komuna e Lipjanit është një nga komunat përfituese të Grantit të Performancës Komunale. Për të rritur cilësinë e projekteve të financuara nga ky grant, një ekip aktivistësh të shoqërisë civile nga Lipjani, i mbështetur nga programi DEMOS, nisi në gusht 2025 nismën e angazhimit qytetar në mbikëqyrjen e implementimit të projekteve publike.

Auditimi Social në Kosovë ka filluar të aplikohet nga DEMOS dhe organizatat e shoqërisë civile që nga viti 2022 dhe është zhvilluar më tej gjatë viteve 2023-2025. Me mbështetjen e projektit DEMOS dhe MAPL-së janë themeluar 35 grupe me më shumë se 700 qytetarë aktivë.

Me mbi 700 anëtarë të përfshirë ndër vite, ekipet e Auditimit Social kanë ofruar mbi 200 rekomandime konkrete për përmirësimin e qeverisjes lokale dhe rritjen e transparencës institucionale.

Gjatë vitit 2025, BIRN dhe D+ së bashku me gjashtë organizata lokale – HANDIKOS Istog, HANDIKOS Kaçanik, HANDIKOS Drenas, OJQ Avoko, YAHR dhe MAMUŞA EMEKÇI KADINLAR DERNEĞİ me mbështetjen e DEMOS, themeluan gjashtë ekipe të Auditimit Social në komunat Dragash, Drenas, Lipjan, Mamushë, Kaçanik dhe Istog. Këto ekipe mbikëqyrën 16 projekte të komunave përfituese dhe u aftësuan përmes trajnimeve të specializuara në bazat e Auditimit Social, menaxhimin financiar dhe komunikimin strategjik.

Në Lipjan, pas hulumtimit dhe konsultimeve me komunitetin, mbi 20 qytetarë u përzgjedhën për t’u bërë pjesë e ekipit të Auditimit Social. Trajnimet përfshinë ligjërim dhe praktikë në terren, duke përfshirë vendosjen e kontakteve me komunën, analizimin e dokumenteve dhe verifikimin e fakteve. Gjatë këtij procesi u kryen vizita në terren dhe takime zyrtare mes komunës dhe Ekipit të Auditimit Social. Ekipi hartoi rekomandime konkrete, të cilat u ndanë me komunën dhe për të cilat Komuna e Lipjanit u zotua për zbatimin e tyre.

Ky proces tregon rëndësinë e angazhimit qytetar në rritjen e transparencës, përmirësimin e menaxhimit të projekteve publike dhe fuqizimin e organizatave lokale në qeverisjen komunale.

GJETJET E PËRGJITHSHME NË KATËR PROJEKTET



Komuna e Lipjanit ka një angazhim serioz në konsultimin e komunitetit në procesin e hartimit të buxhetit.



Komuna mban takime dhe konsultime publike të rregullta me qytetarët.



Përfshirja e grave në procesin e hartimit të buxhetit të komunës vazhdon të mbetet e ulët.



Të katër projektet e audituara janë projekte me rëndësi të madhe për komunitetin e Lipjanit.



Komuna nuk ka organizuar takime të veçanta për prezantimin e projekteve me komunitetet.



Të gjitha projektet janë realizuar përmes procedurës së hapur, duke respektuar parimet e konkurrencës, transparencës dhe barazisë në trajtim.



Afatet për dorëzimin e ofertave ishin të arsyeshme dhe në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.



Në të gjitha rastet, kriteri i dhënies së kontratës ka qenë “çmimi më i ulët”, i cili siguron thjeshtësi dhe transparencë në vlerësim. Megjithatë, në rastet kur objekti i kontratës është puna, do të ishte e dobishme të shqyrtohej përdorimi i kriterit “ekonomikisht më i favorshëm”, i cili mundëson përfshirjen e elementeve shtesë në vlerësim, si cilësia e materialeve, afati i realizimit, garancia e punimeve apo aspektet mjedisore, duke siguruar një qasje më të balancuar ndërmjet çmimit dhe cilësisë së punës.



Nuk janë vërejtur kushte diskriminuese apo kërkesa favorizuese në dosjet e tenderëve.



Në përgjithësi, komunikimi me operatorët ekonomikë ka qenë korrekt, megjithëse në disa raste (si në projektin e Shtëpisë Muze) munguan sqarime të plota për pyetje të drejtpërdrejta.



Numri i ofertuesve ka qenë i mjaftueshëm në të gjitha tenderët, duke dëshmuar interes dhe konkurrencë në treg.



Vetëm një rast u evidentua me ankesë administrative, që u trajtua brenda afatit ligjor dhe nuk ndikoi në procesin e dhënies së kontratës.



Në të gjitha aktivitetet, nuk janë regjistruar ankesa në OShP, gjë që tregon për stabilitet procedural dhe përmbushje të kërkesave ligjore.

Gjetje specifike në projektin “Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturofc dhe Ribar i madh”



Punimet kanë përfunduar brenda afatit të paraparë me kontratë.



Projekti nuk ka paraparë ndërtimin e trotuareve përgjatë gjithë rrugës.



Projekti ka paraparë ndriçim publik të mangët.



Projekti nuk ka përfshirë mbrojtëse dhe sinjalizim të mjaftueshëm.



Platformat e ngritura për ngadalësim të shpejtësisë nuk janë vendosur në mënyrë të përshtatshme në terren.



Gjetje specifike në projektin “Rikonstruktimi i Rrugës Dobrotin – Sllovi”



Mungesa e shportave për mbeturina.



Trotuaret e ndërtuara në disa segmente janë tepër të ngushta dhe nuk përmbushin standardet e qasjes universale.



Muri mbrojtës i ndërtuar nuk është i pajisur me mbrojtëse metalike apo barriera të përshtatshme për siguri.

Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i Shtëpisë Muze të Veteranëve të UÇK-së, Krojmir”



Mungon siguria në vendpunishte;



Ndryshimet në muret e brendshme dhe zhvendosja e tualetit.

Gjetjet specifike në projektin “Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët”



Gjatë vizitës në terren nuk u konstatua asnjë ndërhyrje konkrete – nuk kishte filluar ndërtimi i stacionit të autobusit dhe as muri gabion.



Në zonën e projektit mungonin tabelat informuese dhe pllakata zyrtare mbi kompaninë dhe detajet e projektit.



Punimet u ndaluan nga Inspektorati i MMPHI, pasi projekti nuk mund të niste pa pëlqim paraprak mjedisor, duke qenë se kjo është zonë e mbrojtur.



U evidentua mungesë koordinimi paraprak ndërmjet komunës dhe ministrisë, si dhe mosrespektim i procedurave ligjore për leje dhe pëlqime.



ÇKA DUHET TË DIJË NJË EKIP I AUDITIMIT SOCIAL?

Ekipet e Auditimit Social nuk nevojitet të jenë skajshmërisht profesionale. Ekipet kanë nevojë për vullnet dhe guxim qytetar; si dhe, rekomandohet të kenë njohuritë bazike, në:

- Funkcionimin e Komunës;
- Qasjen në dokumente publike;
- Procesin e konsultimit me publikun - sidomos gjatë planifikimit të buxhetit dhe investimeve në Komunë;
- Procesin e prokurimit publik.

AMBIENTI KU ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Komuna e Lipjanit është në mesin e komunave mesatare në Kosovë me 55,098 banorë sipas regjistrimit të vitit 2024¹, me një buxhet prej 24,897,038.00 euro². Buxheti i komunës për investime kapitale është i vogël dhe ndihma nga projekti i Grantit të Performancës është me ndikim të madh në komunitet.

Lipjani është në mesin e komunave që përfitoi fondet e Grantit të Performancës Komunale. Fondet u vendosën të investoheshin në projektet “Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)”, “Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së, Krojmir”, “Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturofc dhe Ribar i Madh”, dhe “Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Silovi”, për të cilat ishin ndarë 240,228.25 euro³.

Të gjitha këto projekte ishin të një rëndësie të madhe për komunitetet e lokaliteteve përkatëse. Rikonstruktimi i rrugës në fshatin Poturofc, Ribar i Madh dhe rrugës që lidh

fshatin Dobrotin me fshatin Silovi, do të lehtësonte lëvizjen e qytetarëve, qasjen më të shpejtë drejt qendrave të shërbimeve dhe do të ndikonte drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik lokal përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore.

Në anën tjetër, ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së në Krojmir ishte një projekt i kërkuar nga komuniteti i veteraneve për më shumë se pesë vite, dhe realizimi i tij paraqet ruajtjen e kujtesës historike, forcimin e identitetit kolektiv dhe krijimin e një hapësire të dedikuar për nderimin e sakrificës së ish-luftëtarëve.

Së fundmi, projekti i ndërtimit të murit gabion te shpella e Gadimes, si një vend turistik me rëndësi kombëtare, jo vetëm që siguron mbrojtjen e mjedisit natyror nga erozioni dhe shembjet, por edhe kontribuon në rritjen e sigurisë së vizitorëve dhe në zhvillimin e potencialit turistik të zonës.



1 Popullsia në rajone dhe qytete, Agjencia e Statistikave të Kosovës [Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel të komunave, 2017 - 2024](#). (qasur për herë të fundit me 03.10.2025)

2 Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Lipjanit 2025 – 2027 <https://lipjan.rks-gov.net/korniza-afatmesme-buxhetore/> (qasur për herë të fundit me 03.10.2025)

3 Vlera e Grantit të Performancës Komunale për Komunën e Lipjanit <https://helvetas-ks.org/demos3/wp-content/uploads/2024/08/ALB-Rregullat-e-GPK-2025.pdf>

KAPITULLI I

GJETJET E PËRBASHKËTA NË TË KATËR PROJEKTET

Gjatë procesit të Auditimit Social në Lipjan, ekipi trajtoi një varg të temave të cilat u zbuluan gjatë analizimit të dokumenteve dhe

vizitave në terren. Ekipi konstatoi probleme në fazën e konsultimeve me qytetarë, në procesin e planifikimit dhe implementimit të kontratave.



Gjetjet në procesin e konsultimeve me qytetarët

Për qytetarët, komuna mbetet institucioni i parë ku ata drejtohen për të ngritur shqetësimet dhe për të kërkuar adresimin e nevojave komunitare, duke pasur një rol thelbësor në procesin e planifikimit dhe zhvillimit komunal. Ky rol bëhet i prekshëm përmes takimeve dhe konsultimeve publike që organizon komuna me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Për të vlerësuar funksionimin dhe efektivitetin e këtyre proceseve, ekipi i Auditimit Social ka analizuar dokumentacionin e krijuar gjatë konsultimeve publike të mbajtura në Komunën e Lipjanit gjatë vitit 2025.

Komuna e Lipjanit kishte publikuar në uebfaqen e saj njoftimin për dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028, duke paraparë tetë (8) takime konsultative – katër (4) në sallën e Kuvendit Komunal dhe katër (4) të tjera në shkollat fillore të fshatrave⁴. Në këto dëgjime morën pjesë gjithsej 197 qytetarë, prej tyre 38 gra (rreth 19%). Përveç takimeve me qytetarë, komuna kishte organizuar edhe takime të veçanta me gra dhe shoqatat e grave, organizatat e shoqërisë civile, të rinjtë, klubet sportive dhe përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara.

Procesverbalet e dëgjimeve buxhetore për vitet 2026–2028 janë publikuar në uebfaqen e komunës⁵, mirëpo përmbajtja është mjaft e përgjithësuar dhe nuk pasqyron në mënyrë të detajuar nevojat apo kërkesat konkrete të qytetarëve të ngritura gjatë takimeve. Sipas të dhënave të përmbledhura, diskutimet kanë qenë të përqendruara kryesisht në propozime për investime në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi, pa specifikuar më tej llojin apo lokacionin e këtyre investimeve.

Nga analiza e procesverbaleve të publikuara, Ekipi i Auditimit Social vlerëson se pjesëmarrja e grave ishte relativisht e ulët, por është rritur për shkak të takimit të veçantë me gratë dhe shoqatat e tyre, në të cilin morën pjesë 21 gra. Megjithatë, sipas procesverbalit, ky takim rezultoi me diskutim të shkurtër dhe vetëm dy (2) kërkesa të evidentuara. Në katër (4) takimet e mbajtura në fshatrat Gadime, Grackë e Vjetër, Dobrajë e Madhe dhe Krojmir, pjesëmarrja e grave ishte edhe më e ulët – vetëm tetë (8) gra nga gjithsej 108 pjesëmarrës.

Përveç dëgjimeve publike për KAB të mbajtura në qershor të vitit 2025, Komuna e Lipjanit organizoi edhe nëntë (9) dëgjime buxhetore gjatë muajit gusht, me të njëjtit akterë si në dëgjimet paraprake, dhe duke vazhduar në fshatra të tjerë të Komunës si: Grackë e Vjetër, Sllovi, Ribar i Madh, Shalë, Magure dhe me Kryetarët e Këshillave të fshatrave.

⁴ Njoftimet për dëgjime publike [Njoftime për Konsultime Publike - Komuna e Lipjanit](#)

⁵ Procesverbalet e organizimeve të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 [Procesverbale - Komuna e Lipjanit](#)



Projektet ishin nevojë e komunitetit

Projektet e investuara në Komunën e Lipjanit gjatë këtij viti, përmes Grantit të Performancës Komunale, pasqyrojnë kërkesa të qarta të komunitetit dhe ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Rikonstruktimi i rrugëve në Poturofc, Ribar të Madh dhe lidhjes Dobrotin-Slovi përmirëson ndjeshëm infrastrukturën bazë, duke u ofruar banorëve lëvizje më të sigurt, qasje më të shpejtë në shërbime dhe një perspektivë më të favorshme për zhvillimin ekonomik lokal. Ndërtimi i shtëpisë muze të veteranëve në Krojmir ka një rëndësi të veçantë për komunitetin, pasi kjo hapësirë nuk shërben vetëm si përmbushje e një kërkesë shumëvjeçare të veteranëve, por edhe si një vend simbolik ku ruhet dhe nderohet kujtesa

historike e zonës. Shtëpia muze do të bëhet pikë referimi për brezat e rinj, duke ofruar mundësi për të mësuar mbi sakrificat, historitë personale dhe kontributin e atyre që kanë luajtur rol kyç në mbrojtjen dhe lirinë e vendit. Për komunitetin lokal, ky investim përfaqëson më shumë sesa një objekt — është një hap drejt forcimit të identitetit kolektiv, kultivimit të krenarisë historike dhe ruajtjes së vlerave që i kanë bashkuar banorët ndër vite. Po ashtu, investimi në murin mbrojtës gabion pranë shpellës së Gadimes garanton mbrojtjen e mjedisit natyror dhe njëkohësisht rrit atraktivitetin turistik të zonës, duke kombinuar mbrojtjen e trashëgimisë me zhvillimin ekonomik përmes turizmit.



Gjetje të përgjithshme nga aspekti i prokurimit

Procesi i prokurimit për katër projektet e audituara nga Ekipi i Auditimit Social në Komunën e Lipjanit është zhvilluar në përputhje me legjislacionin përkatës për prokurimin publik dhe ka reflektuar një nivel të mirë të transparencës dhe konkurrencës. Të gjitha aktivitetet janë realizuar përmes procedurës së hapur, duke respektuar parimet e barazisë në trajtim dhe të konkurrencës së ndershme. Afatet për dorëzimin e ofertave kanë qenë të arsyeshme, ndërsa komunikimi me operatorët ekonomikë është vlerësuar përgjithësisht korrekt.

Në të gjitha rastet, kriteri i përzgjedhjes së fituesit ka qenë “çmimi më i ulët”, çka ka siguruar thjeshtësi dhe transparencë në vlerësim. Megjithatë, për projektet që përfshijnë punime ndërtimore, do të ishte

e vlefshme të shqyrtohet aplikimi i kriterit “ekonomikisht më i favorshëm”, që do të mundësonte vlerësim më gjithëpërfshirës të ofertave duke marrë parasysh cilësinë, garancinë dhe afatet e realizimit.

Numri i ofertuesve ka qenë i mjaftueshëm në të gjitha tenderët, duke dëshmuar interes të qëndrueshëm nga operatorët ekonomikë dhe konkurrencë të hapur në treg. Gjatë procesit është evidentuar vetëm një rast me ankesë administrative, e cila është trajtuar brenda afateve ligjore dhe pa ndikim në përfundimin e kontratës. Në asnjë rast nuk janë regjistruar ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), çka tregon për stabilitet procedural dhe përmbushje të kërkesave ligjore në të gjitha fazat e procesit të prokurimit.

KAPITULLI II

GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS AJET KOZHANI POTUROFC DHE RIBAR I MADH”

Në projektin “Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturofc dhe Ribar i Madh”, ekipi i Auditimit Social ka konstatuar probleme specifike të cilat lidhen me këtë projekt. Ekipi janë takuar në terren për të inspektuar punët e përfunduara, gjatë të cilit janë takuar edhe me menaxherin e kontratës.

Ndërkohë që janë mbajtur takime publike në secilin fshat, përfshirë Ribar i Madh dhe Poturofc, banorët e zonës kanë

pasur mundësi të monitorojnë punën e kompanisë në vazhdimësi. Kjo përfshirje është e rëndësishme, pasi tregon interesin e drejtpërdrejtë të qytetarëve për projektet publike që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Megjithatë, gjatë monitorimit janë evidentuar një sërë mangësish dhe problematikash të cilat tregojnë se projekti nuk ka reflektuar nevojat reale të komunitetit.



Mungesa e trotuareve

Shqetësimi kryesor i ngritur nga banorët është mungesa e trotuareve përgjatë gjithë rrugës, që nuk është përfshirë fare në projekt. Kjo lë një boshllëk serioz në infrastrukturë, pasi banorët – përfshirë fëmijë, të moshuar dhe gra – detyrohen të ecin në rrugën e automjeteve,

duke rritur rrezikun e aksidenteve. Sipas qytetarëve, një projekt i mirëfilltë rrugor duhet të kishte paraparë trotualet si pjesë të pandashme, e jo të krijonte një gjendje ku këmbësorët janë të ekspozuar përballë rrezikut të veturave.





Ndriçimi publik i mangët

Ndriçimi rrugor është vendosur vetëm pranë disa shtëpive të banimit, ndërsa segmentet e tjera të rrugës mbeten të pa ndriçuara. Kjo krijon vështirësi të mëdha gjatë natës, duke rrezikuar sigurinë e këmbësorëve dhe

drejtuesve të automjeteve. Banorët vunë në dukje se lagje të tjera janë pajisur me ndriçim të plotë, ndërsa rruga në fjalë është lënë pa këtë element bazik të sigurisë dhe jetës urbane.



Mungesa e mbrojtëseve dhe sinjalizimit

Në kthesat e rrezikshme nuk janë vendosur mbrojtëse anësore apo sinjalizim adekuat. Kjo është veçanërisht problematike për drejtuesit e automjeteve, sidomos gjatë kushteve të

vështira atmosferike. Qytetarët e cilësuan këtë si një rrezik të shtuar që duhej të ishte adresuar që në fazën e projektimit.



Platformat e ngritura janë jashtë standardit

Në terren, ekipi i Auditimit Social vërejti se platformat për zvogëlim të shpejtësisë nuk janë realizuar sipas standardeve. Ata janë vendosur pa u respektuar përmasat dhe materialet e duhura, duke shkaktuar probleme në qarkullim, si dëmtime të automjeteve dhe pengesa jo të nevojshme. Megjithatë, pas takimit me

menaxherin e kontratës, banorët u informuan se platforma për këmbësorë pranë shkollës është vendosur në mënyrë të ndryshuar, me qëllim të kontrollimit të shpejtësisë së automjeteve dhe rritjes së sigurisë për këmbësorët, duke marrë parasysh shqetësimet e komunitetit.



Përdorimi i gypave të vjetër tek mbledhësit e ujërave atmosferik

Në terren është vërejtur se gypat e mbledhësve të ujërave atmosferik, të cilët kalojnë nën asfalt, nuk janë ndërruar, por janë përdorur ata të vjetërit. Menaxheri i projektit ka arsyetuar

se gjendja e këtyre gypave ka qenë e mirë dhe nuk ka pasur nevojë për ndërrim, pasi ato kanë funksionuar në mënyrë efikase dhe nuk kanë paraqitur probleme të dukshme.



Aspekti i prokurimit

Procedura u hap më 19.05.2025 me vlerë të parashikuar 309,999.78 euro dhe afat përfundimi 60 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Tenderi, i ndarë në dy lote, u zhvillua me procedurë të hapur dhe me kriter dhënieje “çmimi më i ulët”. U identifikua një korrigjim teknik në përshkrimin e asfaltit, i cili u trajtua

përmes formularit standard për korrigjim të gabimeve. Pjesëmarrja ishte e lartë me 18 operatorë ekonomikë, dhe kontrata iu dha Agim Morina B.I. me vlerë 266,715.00 euro. Ekipi i Auditimit Social nuk evidentoi kërkesa diskriminuese apo favorizuese, si dhe nuk kishte ankesa apo vonesa procedurale.

KAPITULLI III

GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS DOBROTIN – SLOVI”

Në projektin “Rikonstruktimi i rrugës Dobrotin – Slovi”, banorët e të dy fshatrave kanë shprehur kënaqësi të madhe për realizimin e punimeve. Rruga e re ka lehtësuar ndjeshëm qarkullimin e automjeteve, ka përmirësuar lidhjen mes dy fshatrave dhe ka rritur sigurinë e përdoruesve. Përmirësimi i ndriçimit në një rën pjesë të lagjes ku kishte nevojë, është

konsideruar një përfitim i madh, sidomos për lëvizjen gjatë orëve të mbrëmjes. Për banorët, ky projekt ka sjellë një ndryshim të dukshëm në cilësinë e jetesës së tyre të përditshme.

Megjithatë, gjatë monitorimit në terren dhe përmes diskutimeve me qytetarët, u evidentuan disa problematika dhe mangësi që duhen adresuar:



Mungesa e shportave për mbeturina

Gjatë inspektimit në terren është vërejtur se përgjatë rrugës, veçanërisht në afërsi të shkollës, ambulantës dhe hapësirave më të frekuentuara nga qytetarët, mungojnë


shportat për mbeturina. Kjo paraqet vështirësi për mirëmbajtjen e pastërtisë publike dhe rrit mundësinë e hedhjes së mbeturinave në mënyrë të parregullt.



Gjerësia dhe përshtatshmëria e trotuarit

Në disa segmente të rrugës janë ndërtuar trotuare, por ato janë tepër të ngushta dhe nuk i përmbushin standardet për përdorim nga grupe të cënueshme si persona me aftësi të kufizuara, persona të verbër apo nëna me fëmijë në karroca. Po ashtu, nuk janë vendosur pllaka taktile për orientim të personave të verbër, sidomos pranë vendeve të frekuentuara si shkolla, QKMF, gjë që kufizon funksionalitetin dhe bie ndesh me parimet e qasjes universale.





Muri mbrojtës jo i përshtatshëm

Në një pjesë të rrugës është ndërtuar një mur për të parandaluar shembjen e dheut. Megjithatë, mungesa e mbrojtëseve metalike ose barrierave të tjera të përshtatshme e bën

këtë segment potencialisht të rrezikshëm për automjetet dhe kalimtarët. Banorët e cilësuan këtë si një pikë të dobët të projektit, që kërkon ndërhyrje të menjëhershme.



Aspekti i prokurimit

Tenderi u hap më 19.05.2025 me vlerë të parashikuar 270,000 euro dhe afat përfundimi 90 ditë. Procedura ishte e hapur dhe pa kushte diskriminuese. Pesë operatorë dorëzuan oferta, dhe kontrata iu dha Bageri SH.P.K. me ofertë 267,381.95 euro. Pati një ankesë lidhur me vlerësimin e ofertave, e cila u trajtua nga komuna dhe u konsiderua pjesërisht e bazuar,

por nuk solli ri-vlerësim apo ndryshim të vendimit për dhënie të kontratës. Ankuesi nuk iu drejtua OShP-së, dhe procesi u përmbyll pa vonesa të mëtejshme. Ekipi i Auditimit Social nuk evidentoi kërkesa diskriminuese apo favorizuese, ndërkohë që kriteri i dhënies ishte çmimi më i ulët.

KAPITULLI IV

GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “NDËRTIMI I SHTËPISË MUZE TË VETERANËVE TË UÇK-SË, KROJMIR”

Ekipi i Auditimit Social vizitoi vendpunishten ku po zhvillohej projekti. Banorët dhe Shoqata e Veteranëve të UÇK-së kanë vlerësuar lartë realizimin e kërkesës së tyre, e bërë pesë vite më parë. Përfaqësuesit e shoqatës theksuan se ky projekt ka një rëndësi të madhe historike dhe shoqërore për komunitetin, duke qenë se ruan kujtesën kolektive dhe përkujton sakrificën e ish-luftëtarëve.

Banorët dhe përfaqësuesit e shoqatës kanë ndjekur vazhdimisht nga afër procesin e punimeve dhe kanë qenë të pranishëm gjatë monitorimit në terren. Në inspektim mori pjesë edhe përfaqësuesi i punëkryesit, i cili shpjegoi ecurinë dhe sfidat e deritanishme të projektit.

Gjatë diskutimeve dhe vëzhgimeve në terren, u evidentuan disa ndryshime dhe çështje që kanë rëndësi për ecurinë dhe funksionalitetin e objektit:



Mungesa e sigurisë në vendpunishte

Gjatë vizitës në terren, u vërejt se punishtja nuk ka qenë e rrethuar plotësisht, dhe mungesa e shiritave mbrojtës paraqet rrezik për kalimtarët, veçanërisht për fëmijët dhe banorët që kalojnë afër. Gjithashtu, materialet

ndërtimore, përfshirë pllakat dhe pajisjet e tjera, ishin të vendosura pa mbrojtje të mjaftueshme, duke rritur rrezikun për aksidente dhe duke e vështirësuar qasjen e sigurt të punëtorëve.



Ndryshimet në muret e brendshme dhe zhvendosja e tualetit

Banorët dhe Shoqata e Veteranëve kanë sugjeruar disa ndryshime në organizimin e hapësirave të brendshme të objektit për të përmirësuar funksionalitetin dhe për t'iu përshtatur më mirë nevojave të komunitetit. Konkretisht, ata propozuan që muri ekzistues të zhvendoset në një pjesë të objektit, për

të krijuar një ndarje të qartë të hyrjes drejt katit të sipërm për ata që dëshirojnë të përdorin këtë nivel. Gjithashtu, është sugjeruar rivendosja e banjos në një hapësirë tjetër në katin e fundit, dhe jo aty ku ishte paraparë në projekt, për të optimizuar shfrytëzimin e hapësirës.



Aspekti i prokurimit

Procedura e hapur është shpallur më 22.05.2025, me vlerë të parashikuar 122,000 euro dhe afat zbatimi 12 muaj. Afatet e ofertimit ishin të mjaftueshme, megjithëse gjatë procesit u bënë disa ndryshime në paramasa dhe kërkesa teknike. Gjatë fazës së sqarimeve, autoriteti kontraktues nuk i është përgjigjur plotësisht disa pyetjeve të operatorëve ekonomikë, duke iu referuar vetëm Dosjes së Tenderit, një praktikë

që mund të përmirësohet për rritjen e transparencës. Pesë operatorë morën pjesë dhe kontrata iu dha “Archi Time” SH.P.K. me vlerë 121,555.55 euro. Tre ofertues kishin çmime mbi vlerën e parashikuar, ndërsa një u eliminua për mungesë të sigurimit të tenderit. Ekipi i Auditimit Social nuk evidentoi kërkesa diskriminuese apo favorizuese, si dhe nuk kishte ankesa, dhe procedura përfundoi pa vonesa.



KAPITULLI V

GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “NDËRTIMI I MURIT GABION, RREGULLIMI I PARKINGUT DHE NDËRTIMI I STACIONIT TË AUTOBUSIT NË GADIME TË ULËT”

Gjatë vizitës në terren, ekipi i Auditimit Social ka konstatuar se në zonën ku ishte paraparë të realizohet projekti “Ndërtimi i murit Gabion, rregullimi i parkingut dhe ndërtimi i stacionit të autobusit në Gadime të Ulët”, nuk ishte ndërmarrë asnjë ndërhyrje fizike. Nuk ishte filluar ndërtimi i murit gabion apo stacionit të autobusit, dhe mungonin tabelat informuese apo pllakata zyrtare që duhet të vendosen në çdo projekt publik për transparencë dhe informim të qytetarëve.

Në komunikim me zyrtarët e Komunës së Lipjanit dhe pas verifikimit të dokumentacionit, është konfirmuar se punimet janë pezulluar më 04.09.2025 nga Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), pas vizitës në terren dhe kërkesës nga Drejtoria për Menaxhimin e Monumenteve të Natyrës me Rëndësi të Veçantë. Arsyeja e pezullimit ishte se komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe

planifikimit pa pasur pëlqimin mjedisor të nevojshëm, ndonëse zona e Shpellës së Gadimes është e shpallur Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë dhe kërkon leje të posaçme për çdo ndërhyrje.

Komuna ka paraqitur kërkesë për “leje mjedisore” tek MMPHI vetëm më 09.09.2025, pra pas pezullimit të punimeve, duke konfirmuar mungesën e koordinimit paraprak ndërmjet institucioneve. Nga ana tjetër, MMPHI ka kërkuar dokumentacion shtesë (përfshirë planin 3D dhe specifikimet teknike) për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të projektit në zonën e mbrojtur.

Ky rast tregon për mungesë të planifikimit institucional dhe zbatim të mangët të procedurave ligjore nga ana e Komunës së Lipjanit. Si pasojë, është shkaktuar pezullim i punimeve, vonesë në realizimin e projektit dhe pasiguri tek komuniteti lokal mbi afatet dhe përfundimin e tij.



Aspekti i prokurimit

Procesi i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me vlerë të parashikuar prej 60,000 euro. Afatet e parashikuara për dorëzimin e ofertave dhe përfundimin e punimeve ishin të arsyeshme, ndërsa është publikuar edhe formulari për korrigjimin e gabimeve në paramasë. Në këtë tender morën pjesë tre operatorë ekonomikë, dhe kontrata iu dha grupit të operatorëve EURO RAKETA

SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. me ofertë 59,925.88 euro. Dy ofertues të tjerë u eliminuan për mosplotësim të kërkesave teknike. Ekipi i Auditimit Social nuk evidentoi kërkesa diskriminuese apo favorizuese, dhe për këtë aktivitet nuk pati ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), çka tregon për një proces të qetë dhe transparent të prokurimit.

REKOMANDIME

Ekipi i Auditimit Social në fund të projektit ka analizuar punën dhe ka arritur në disa përfundime.

Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve dhe në procesin e prokurimit publik



- Komuna të organizojë konsultime publike që në fazën e hershme të ideimit të projekteve, me qëllim që të identifikohen më saktë nevojat dhe shqetësimet e komunitetit dhe të shmangen pengesat e mundshme gjatë zbatimit.
- Komuna inkurajohet të promovojë dhe të fillojë zbatimin e buxhetimit me pjesëmarrje për projekte të caktuara, si mekanizëm praktik për përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve komunale.
- Komuna duhet të ndërmarrë hapa konkretë për të rritur pjesëmarrjen e grave në dëgjimet buxhetore, përmes ftesave të drejtpërdrejta, bashkëpunimit me organizatat e grave dhe përshtatjes së orarit të takimeve.
- Projektet madhore që prekin drejtpërdrejt interesat e qytetarëve të diskutohen publikisht përpara miratimit, duke u mundësuar qytetarëve të japin komente dhe sugjerime për përmirësim.

Rekomandimet për projektin rikonstruktiv i rrugës Ajet Kozhani – Poturofc dhe Ribar i Madh



- Përfshirja e trotuareve në projekt: Komuna duhet të rishqyrtojë projektin duke planifikuar ndërtimin e trotuareve përgjatë gjithë rrugës, për të garantuar sigurinë e këmbësorëve.
- Ndriçim i plotë publik: Të vendoset ndriçim rrugor në të gjitha segmentet e rrugës, për të rritur sigurinë dhe cilësinë e jetës së banorëve.
- Vendosja e mbrojtëseve dhe sinjalizimit: Në kthesat e rrezikshme të instalohen mbrojtëse anësore dhe tabela sinjalizuese sipas standardeve të sigurisë rrugore.
- Përfshirje më e thelluar e komunitetit: Në fazën e projektimit dhe implementimit, të merret parasysh feedback-u i qytetarëve për të shmangur përsëritjen e mangësive të ngjashme.

Rekomandimet për projektin rikonstruktimi i rrugës Dobrotin – Sllovi



- Të përshtatet gjerësia e trotuareve sipas standardeve, duke mundësuar përdorim të sigurt për persona me aftësi të kufizuara, persona të verbër dhe nëna me fëmijë në karroca.
- Të vendosen pllaka taktile për orientimin e personave të verbër në trotuare, sidomos në pjesët më të frekuentuara të lagjes; në prani të shkollës dhe QKMF.
- Vendosja e shportave për mbeturina: Shtimi i shportave në zona të përshtatshme përreth shkollës dhe ambulants për të mbajtur ambientin të pastër dhe për të mësuar fëmijët për përgjegjësitë ndaj mjedisit.
- Në segmentin ku është ndërtuar muri mbrojtës, të vendosen barriera mbrojtëse të përshtatshme për të garantuar sigurinë e automjeteve dhe kalimtarëve.



Rekomandimet për projektin ndërtimi i shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së në Krojmir



- Vendpunishtja duhet të rrethohet plotësisht dhe të pajiset me shirita mbrojtës për të siguruar kalimin e sigurt të qytetarëve, veçanërisht fëmijëve dhe banorëve që kalojnë pranë.
- Materialet ndërtimore dhe pajisjet duhet të vendosen në mënyrë të sigurt për të shmangur rrezikun e aksidenteve dhe për të garantuar kushte pune të sigurta për punëtorët.
- Të shqyrtohet zhvendosja e murit ekzistues për të krijuar një ndarje të qartë të hyrjes drejt katit të sipërm.
- Të rivendoset tualeti në një hapësirë më të përshtatshme në katin e fundit për të optimizuar shfrytëzimin e hapësirës.
- Çdo ndryshim i ndërmarrë duhet të bëhet në konsultim me komunitetin e Krojmirit dhe shoqatën e veteranëve, për të siguruar që objektet përmbushin qëllimet sociale dhe historike të projektit.



Rekomandimet për projektin e ndërtimit të murit gabion, rregullimit të parkingut dhe stacionit të autobusit në Gadime të Ulët



- Të sigurohet koordinim i plotë paraprak ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe MMPHI-së për projektet që zhvillohen në zona të mbrojtura, në mënyrë që të shmangen pezullimet dhe vonesat.
- Të merren paraprakisht të gjitha lejet dhe pëlqimet mjedisore të kërkuara me ligj, përpara fillimit të procedurave të prokurimit dhe punimeve.
- Të rritet transparenca dhe komunikimi publik, përmes publikimit të informacionit për projektet dhe vendosjes së tabelave informuese në terren.
- Të zgjatet plani dinamik dhe të komuna të paiset me leje mjedisore në mënyrë që të fillojë puna sa më shpejtë.

METODOLOGJIA

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me komunitetin. Në muajin korrik, DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në standarde

të paracaktuara përzgjedhi 16 projekte në 6 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social. Në kuadër të procesit të Auditimit Social u përfshinë 16 projekte në gjashtë komuna.

Emri i projektit	Komuna	Vlera	Faza e projektit në nisjen e auditimit
Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)	Lipjan	59,925.88 €	Implementim
Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir	Lipjan	121,555.55 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi	Lipjan	267,381.95 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturovc dhe Ribar i Madh	Lipjan	266,715.00 €	Implementim
Gjenerator dhe paisje elektrike për pastrimin e dysHEMEVE-për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)	Mamushë	52,333.66 €	Tenderim
Asfaltimi i Rrugës Llapushnik-Berishë-Faza e dytë	Drenas	497,724.00 €	Implementim
Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-Faza e dytë	Drenas	299,652.50 €	Implementim
Rehabilitimi rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc-Vuçak	Drenas	700,000.00 €	Tenderim
Instalimi i paneleve solare në kulmin e objekti të Komunës	Drenas	17,812.32 €	Tenderim
Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Lokacionet - Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	Kaçanik	241,111.11 €	Implementim
Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj	Kaçanik	260,885.45 €	Implementim
Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad	Dragash	80,299.82 €	implementim

Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës	Dragash	101,994.69 €	Implementim
Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash	Dragash	135,329.28 €	Implementim
Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)	Dragash	122,219.00 €	Tenderim
Ndërtimi i Shtratit të Lumit Istog dhe Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë	Istog	Vlera e parashikuar e kontratës është 7,498,356 € (Shtrati i lumit) 301,155 € (rrugët)	Tenderim Implementim

Kush e themelon ekipin e Auditimit Social?

Ekipet e Auditimit Social janë të pavarura nga institucionet dhe mund të themelohen nga përfaqësues të komunitetit por edhe nga

grupe të tjera. Ekipet funksionojnë të pavarura nga qeverisja dhe nuk nevojitet miratim nga institucionet publike për themelimin e tyre.

Si u grumbulluan të dhënat?

Për përpilimin e këtij raporti ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.

Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, ekipi hartoi një listë me pyetje për projektet dhe kërko informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizoi dokumentet e pranuar nga Komuna. Për

të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Lipjanit.

Të dhënat në raport janë grumbulluar nga 25 anëtarët e ekipit të Auditimit Social dhe raporti është hartuar OJQ YAHR, me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të D+. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Lipjanit.


Validimi i të dhënave

Ekipi i Auditimit Social në Lipjan ka punuar në identifikimin e problemeve në projektin e implementuar në këtë komunë për të shkruar raportin. Në takimet e mbajtura ekipi u dakordua për gjetjet e përgjithshme rreth komunës dhe për gjetjet specifike të katër projekteve të monitoruara. Ekipi u dakordua

edhe për rekomandimet e paraqitura në këtë raport. Pas strukturimit të gjetjeve ekipi është takuar me nënkryetarin e komunës dhe ka kërkuar komente nga komuna për gjetjet në raport. Para publikimit komuna ka pranuar raportin për komente eventuale.

Përbërja e ekipit

Përbërja e ekipit: **25 anëtarë.**



Drejtor Shkolle; Arsimtarë; Kryetar të Këshillave Lokalë; Përfaqësues të HANDIKOS; Staf të QKMF; Inxhinier Teknik; Arkitekt; Bibliotekist; Jurist; Ekonomist; Veteran të UÇK-së; Student; Gazetar; Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social;

Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social

Shtator 2025	<ul style="list-style-type: none">● Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën e Lipjanit● Publikimi i materialeve promovuese në rrjetet sociale● Trajnimi për OJQ-të lokale, partnere të projektit● Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit● Përgatitja e listës me profilet e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social nga OJQ YAHR● Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social● Dërgimi i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën e Lipjanit● Trajnimi i ekipit të Auditimit Social● Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber● Pranimi i përgjigjeve dhe dokumenteve të kërkuara nga Komuna e Lipjanit● Trajnimi, diskutimi dhe analizimi i dokumenteve të pranuar nga komuna● Vizita në terren e ekipit të Auditimit Social në projektet për monitorim● Takimi i ekipit me Menaxherët e Kontratave● Vizita e radhës në teren e ekipit të Auditimit Social
Tetor 2025	<ul style="list-style-type: none">● Takimi i ekipit të Auditimit Social për analizimin e të gjitha dokumenteve të pranuar nga Komuna e Lipjanit● Vizita në teren nga ekipi i Auditimit Social● Takimi i ekipit për dakordimin e gjetjeve dhe rekomandimeve finale në draftimin e raportit● Vendosja e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit● Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social



EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË LIPJAN

Nr.	Emri / Mbiemri	Profesioni / Funkzioni
1	Xhyle Korpuzi	Arsimtare e Edukatës Fizike/ Kryetare e Këshillit të Fshatit Shalë
2	Musafë Rexhepi	Pensionist / Kryetar i Këshillit të fshatit Gadime
3	Afrim Mena	HANDIKOS
4	Afrim Sefedini	HANDIKOS
5	Pajtim Sadiku	Anëtar i Këshillit të fshatit Poturovc
6	Fadil Aliu	Këshilli i fshatit Gadime
7	Sinan Qeriqi	Kryetar i Këshillit Lokal të fshatit Krojmir
8	Azem Olluri	Teknik medicinal, QKMF
9	Art Krasniqi	Student i mjekësisë
10	Mehmet Behluli	Pensionist / Anëtar i Këshillit të fshatit Poturovc
11	Nehat Tepeza	Gjuhëtar / Drejtor i shkollës në Ribar i Madh
12	Shefket Tepeza	Inxhinier teknik
13	Isa Grajqevci	Punëtor teknik në shkollën e Ribarit të Madh
14	Halil Kozhani	Qytetar
15	Artiola Krasniqi	Arkitekte
16	Sami Qeriqi	Veteran i UÇK-së
17	Hazbi Demiri	Bibliotekist
18	Sylejman Bllaca	Kryetari i Këshillit të fshatit Ribar i Madh
19	Mirsad Smajli	Kuzhinier
20	Fahri Zeqiri	Jurist
21	Burhan Berisha	Ekonomist
22	Rexhep Isufi	Gazetar
23	Sadet Olluri	Veteran i UÇK-së
24	Brahim Qeriqi	Veteran i UÇK-së
25	Aulona Jashari	Studente

LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT



Është kënaqësi e veçantë të ndaj me ju raportin e këtij viti të Auditimit Social, një dokument që reflekton përkushtimin tonë të vazhdueshëm ndaj transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë lokale. Ky proces është bërë tashmë pjesë e kulturës sonë institucionale, duke na mundësuar të vlerësojmë punën e krye, të identifikojmë arritjet dhe të adresojmë sfidat me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët tanë.

Edhe këtë vit, Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me programin DEMOS, ka realizuar me sukses Auditimin Social, duke dëshmuar përkushtimin tonë për të dëgjuar zërin e qytetarëve dhe për ta përfshirë atë në proceset vendimmarrëse. Ky partneritet ka treguar se rezultatet më të mira arrihen kur bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe komunitetit është i hapur, i ndershëm dhe i orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë mbi këtë bazë të fortë, duke e kthyer këtë proces në një praktikë të qëndrueshme që e ndihmon komunën tonë të përmirësojë mënyrën e qeverisjes dhe të ofrojë shërbime më cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të barabarta për të gjithë qytetarët.

Në fund, dua të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për ekipet lokale të auditimit, për organizatat D+, YAHR dhe DEMOS, si dhe për të gjithë ata që kontribuuan në këtë proces. Falë mbështetjes dhe bashkëpunimit tuaj, po ndërtojmë një administratë më transparente, më efektive dhe më afër qytetarëve.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar të jetë një shembull pozitiv i qeverisjes lokale që vendos qytetarin në qendër të çdo vendimi.

*Me respekt,
Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit*

LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E LIPJANIT

Procesi i Auditimit Social për ne, si qytetarë të Komunës së Lipjanit, ka qenë një përvojë shumë e vlefshme. Përmes trajnimit që kemi ndjekur dhe bashkëpunimit të ngushtë me organizatën D+ dhe YAHR, kemi fituar njohuri të rëndësishme rreth metodologjisë së këtij procesi dhe mënyrës se si qytetarët mund të përfshihen drejtpërdrejt në monitorimin e projekteve komunale.

Ky proces na ka mundësuar të kuptojmë më mirë rëndësinë e përfshirjes qytetare në mbikëqyrjen e punëve publike, duke nxitur bashkëpunim ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve komunale. Një aspekt që e vlerësojmë veçanërisht është përfshirja e qytetarëve me profesione e përvoja të ndryshme, gjë që ka kontribuar në një qasje gjithëpërfshirëse dhe më efektive ndaj monitorimit.

Gjatë zbatimit të Auditimit Social kemi identifikuar disa çështje që, sipas nesh, mund të përmirësohen për të rritur funksionalitetin dhe cilësinë e projekteve të realizuara nga komuna. Të gjitha këto vërejtje dhe rekomandime janë adresuar tek autoritetet komunale, me qëllim që të kontribuojmë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Ne, si grup i Auditimit Social, e konsiderojmë këtë metodologji si një praktikë që forcon ndjeshëm qytetarinë aktive, bashkëpunimin me Këshillat Lokale dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Besojmë se vazhdimi dhe institucionalizimi i kësaj qasjeje do të ndikonte pozitivisht në transparencën komunale dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Shpresojmë që Auditimi Social të shndërrohet në një praktikë të rregullt pune në nivel lokal, duke u mbështetur nga të gjitha palët e interesuara për të ndërtuar një qeverisje më të hapur, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse.





Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige